



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:914391

Datë: 01.08.2022

Numri i dokumentit: 03282574

A.C.nr.5741/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Naime Ahmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve M.H., F.H., SH.H., A.H.1., dhe A.H.2., që të gjithë me vendbanim në Rr. "...",, .., Komuna Prishtinë, të cilët i përfaqëson me autorizim N.P., avokat me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurit S. (N.) S., me vendbanim në Rr. ".....", p.n, Komuna Prishtinë, në çështjen kontestimore për kompensim të dëmit jomaterial, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.1903/15 datë 14.03.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.07.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë, ankesa e paditësve M.H., F.H., SH.H., A.H.1., dhe A.H.2., që të gjithë me vendbanim në Rr. "...",, .., Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.1903/15 datë 14.03.2019, sa i përket pikës II, për shpenzimet e procedurës, **VËRTETOHET**.

II. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.1903/15 datë 14.03.2019, në pikat, I dhe III, dhe kamatës të vendosur, mbetet i pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.1903/15 datë 14.03.2019, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

"... APROVOHET PJESERISHT SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditësve, F.H., SH.H., M.H., A.H.1., dhe A.H.2. qe te gjithë nga Prishtina rr."..." ,

I. DETYROHET i padituri S. (N.) S. nga Prishtina, rr.".....", p.n qe paditesit ne emër te kompensimit te demit jo material, qe i eshte shkaktuar me plagosje, me date 31.07.2044, t;ia paguaj shumat si vijon dhe ate:

I.a) ne emër te demit jo material per paditesit:

- per M.H. ne shume prej 7.000 Euro
- per F.H. ne shume prej 4.000 Euro
- per SH.H. ne shume prej 4.000 Euro
- per A.H.1. ne shume prej 2.000 Euro
- per A.H.2. ne shume prej 2.000 Euro

II. DETYROHET I padituri S. (N.) S. nga Prishtina, rr. "...", p.n qe paditesve si ne piken I te dispozitivit te ketij aktgjykimi, t'ia paguaj Shumen me kamate vjetore prej 8% duke filluar nga dita e marrjes se ketij aktgjykimi me date 14.08.2015 e deri ne pagesen definitive, per pjesen e gjykuar te kompensimit, si dhe shpenzimet e procedures ne shume prej 3,294.80 €, te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes se aktgjykimit...".

Me datë 10.04.2019, i autorizuari i paditësve ka parashtruar në Gjykatën e shkallës së parë parashtrësë për korigjimin e aktgjykimit C.nr.1903/15.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr.1903/15 datë 15.04.2019, e ka korigjuar Aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë C.nr.1903/15 datë 14.03.2019.

Aktgjykimin C.nr.1903/15 datë 14.03.2019, dhe aktvendimin C.nr.1903/15 datë 15.04.2019, e kanë pranuar palët ndërgjyqëse, kjo vërtetohet nga fletëkthesat e dorëzuara në Gjykatën e shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.1903/15 datë 14.03.2019 brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësve, për shkak të: shpenzimeve procedurale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, qe ta aprovoj ankesën, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet për pjesën e shpenzimeve procedurale, që e paditura palës paditëse në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj shumen prej 6,832.40 Euro.

Përgjigje në ankesë, dhe ankesë nuk është parashtruar nga ana e të paditurit.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e paditësve, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit M.H., F.H., SH.H., A.H.1., dhe A.H.2., që të gjithë me vendbanim në Rr. "...", .. ., .. ., Komuna Prishtinë, me datë 14.08.2015, kanë parashtruar padi ndaj të paditurit, S. (N.) S., me vendbanim në Rr. "...", p.n, Komuna Prishtinë, me kërkesë për kompensimin e dëmit jo material.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 14.03.2019, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.1903/15 datë 14.03.2019, me të cilin aktgjykim e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *"...E drejta për të kompensuar demin dhe detyrimi për kompensimin e tij janë të rregulluara me Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Kështu sipas nenit 137 par.1 të këtij ligji ai që e shkakton demin është i detyruar që ta kompensojë atë në qoftë se nuk dëshmon se demin është shkaktuar pa fajin e tij. Në rastin konkret është vërtetuar se demin të cilin iu ka shkaktuar paditësve, si pasoje e sulmit të paditësit të parë, e i cili konsiston në përjetimin e frikës, e ka shkaktuar i padituri me fajin e tij, gjykata me aplikimin e dispozitës së cekur ligjore në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroi të paditurin t'ua kompensojë demin e pësuar në shumat e gjykuara... Vendimin që pala e paditurit të bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK..."*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes së dispozitivit të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi ankimor i paditësit lidhur me shpenzimet procedurale, është i pabazuar, pasi që vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 par. 1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.1903/15 datë 14.03.2019, në pikat I dhe III, dhe kamatës së vendosur mbetet i pa shqyrtuar, pasi që këto pika nuk janë atakuar me ankesë nga pala ankuese.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.5741/2019 datë 20.07.2022

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi